



# MBROJTJA E FËMIJËVE NGA SHFRYTËZIMI SEKSUALE NË TURIZËM

Vëzhgim studimor mbi risqet që paraqet sektori  
dhe zhvillimi i turizmit në Shqipëri për  
shfrytëzimin seksual të fëmijëve

Tiranë, Maj 2022



# Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm

## SHQIPËRI

Vëzhgim studimor

Raporti u përgatit nga:

Belioza ÇOKU

Linda PINO

Altin HAZIZAJ

Tiranë, Maj 2022

Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (Child Rights Center Albania) - CRCA/ECPAT Shqipëri, është organizata më e vjetër për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në vendin tonë, e themeluar në vitin 1997. CRCA/ECPAT Shqipëri punon për të promovuar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, për t'i mbrojtur nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, nëpërmjet advokimit, përmirësimit të legjislacionit dhe politikave, rritjes së kapaciteteve, hulumtimeve, si dhe identifikimit dhe përdorimit të praktikave më të mira të shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë.

**Disclaimer:** Opinionet dhe mendimet e shprehura në këtë botim jo detyrimisht shprehin qendrimet, mendimet apo opinionet e ECPAT Gjermani dhe mbështetësve të këtij studimi apo ato të CRCA/ECPAT Shqipëri. Ato shprehin vetëm opinionet dhe qendrimet e autorëve të studimit.

**In cooperation with:**



**Supported by the**



Federal Ministry  
for Economic Cooperation  
and Development

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

**Referencat e publikimit:**

- Coku B., Pino L., Hazizaj A., Protecting children from sexual exploitation in travel and tourism in Albania. CRCA/ECPAT Albania, Maj 2022.
- Coku B., Pino L., Hazizaj A., Mbrojtja e Fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm. CRCA/ECPAT Shqipëri, Maj 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky botim ose pjesë të tij nuk mund të riprodhohen ose përdoren në asnjë mënyrë pa leje me shkrim nga CRCA/ECPAT Shqipëri, përveç përdorimit të citateve të shkurtra në botime që i referohen këtij raporti.

Shtypur në Tiranë, Shqipëri.

copyright © 2022 CRCA/ECPAT Shqipëri

## Terminologji dhe shkurtime

ALO 116	Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijët
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
CRCA	Qendra për Të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri
ECPAT	Ndal Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve
OJF	Organizatë joqeveritare
ADRA	Agjencia Adventiste për Ndihmë dhe Zhvillim
TdH	Terre des Homme

## Mirënjohe dhe falenderime

Është hera e parë që në Shqipëri botohet një vëzhgim i plotë mbi shfrytëzimin e fëmijëve në sektorin e turizmit, udhëtimeve, hotelarisë dhe mikëpritjes në tërësi. Masivizimi i turizmit dhe rritja e fluksit të turistëve si vendas ashtu edhe të huaj, ka bërë që të rriten raportimet e fëmijëve për ngjarje të dhunës dhe shfrytëzimit seksual, apo të njoftimeve të policisë për ndalimin dhe arrestimin e shfrytëzuesve të fëmijëve për prostitucion.

Nisur nga kjo, CRCA/ECPAT Shqipëri me mbështetjen e ECPAT Gjermani ndërmorrën një ushtrim të përbashkët për të vëzhguar dhe njohur situatën dhe për të kuptuar sesi në tërësi industria e turizmit kontribuon apo rrit riskun që fëmijët të bëhen viktimat të shfrytëzimit seksual në turizëm, në hotele apo dhoma që jepen me qera, nëpërmjet komunikimit elektronik apo vizitave të organizuara qëllimisht për të shfrytëzuar varfërinë e fëmijëve për qëllime seksuale. Motivet dhe arsyet mund të jenë nga më të ndryshmet, por rezultati mbetet po ai: turistë vendas dhe të huaj, që udhëtojnë e qëndrojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë me një qëllim të vetëm – të abuzojnë seksualisht fëmijët dhe ti kthejnë ata në viktimat të krimeve të tyre.

Në këtë aspekt ne kemi mbetur të shtangur nga mungesa e informimit dhe qasja naive e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, si dhe në tërësi e të gjithë sektorit të turizmit në Shqipëri, në lidhje me faktin që fëmijët në Shqipëri shfrytëzohen seksualisht në industrinë e turizmit. Ne shpresojmë sadopak që ky studim do të rrisë seriozisht vëmendjen dhe veprimet e tyre përkundrejt një fenomeni kaq të dëmshëm, jo vetëm për fëmijët, por edhe Shqipërinë dhe industrinë e turizmit. Ne nuk besojmë se autoritetet shtetërore të turizmit dhe vetë industria duan të identifikohen si lejues apo mbështetës të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Shqipëri nga pedofilët dhe grabitqarët seksuale.

CRCA /ECPAT Shqipëri falenderon në mënyrë të veçantë autorët e këtij studimi, në mënyrë të posaçme Dr. Belioza Çoku që udhëhoqi ekipin e CRCA/ECPAT Shqipëri në mbledhjen e fakteve dhe të dhënave e më pas analizën dhe parashkrimin e tyre. Ne gjithashtu falenderojmë ECPAT Gjermani që falë mbështetjes së tyre ne patëm mundësi të ekploroni një fushë të pastudiuar më parë, e cila do të na jap mundësi që të adresojmë gjetjet dhe rekomandimet e studimit.

# 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sipas Raportit të Impaktit Ekonomik të Udhëtimit dhe Turizmit 2018, të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit<sup>1</sup> (ËTTC), përgjatë vitit 2017, sektori i turizmit regjistroi një kontribut direkt prej 1.12 bln\$ duke përbërë rreth 8.5% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), ndërkohë duke përfshirë edhe efektet indirekte multiplikative, kontributi total është thuhetse trefish më i lartë prej 3.47 bln\$, duke përbërë rreth 26.2% të PBBsë, duke e pozicionuar këtë sektor si një ndër kontribuesit kryesor të zhvillimit të ekonomisë kombëtare.

Ndërkohë për 10 vjeçarën e ardhëm parashikohet një rritje e konsiderueshme e kontributit të këtij sektori në ekonomi, ku vetëm në 2-3 vite sektori i turizmit pritet të zërë 8,8% të PBB ndërkohë që deri në 2028, sektori mund të zërë deri në 9.3 % të PBB. Kësisoj, duke marrë në konsideratë këtë trend rritës, parashikohet që deri në 2028 efekti direkt dhe indirekt i sektorit të turizmit t'i afrohet rreth 1/3 të të gjithë Produktit të Brendshëm Bruto të Shqipërisë.

Po ashtu, referuar punësimit, aktualisht në sektorin e turizmit janë punësuar rreth 7.7% e të gjithë forcës së punës në Shqipëri, ndërkohë që deri në 2028 parashikohet që ky numër të rritet në nivelin 8.8 %. Referuar të njëjtit raport të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (ËTTC), investimet në këtë sektor përbënin rreth 7.5 % të të gjithë investimeve në vend, ndërkohë që deri në 2028 parashkohet që kjo shifër të rritet në nivelin 8,2%.

Rritja e shpejtë e turizmit kombëtar dhe ndërkombëtar, nuk përfaqëson vetëm një përfitim ekonomik për vendin tonë dhe për shumicën e destinacioneve turistike. Ndonjëherë ky komponent mund të prodhojë dhe ndikime negative socio-kulturore, të cilat bëhen të dukshme në veçanti, në rastin e shfrytëzimit të qenieve njerëzore nëpërmjet turizmit seksual.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve për përfitim në Shqipëri, u shfaq pas 1990, si rezultat i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike që ndodhën gjatë asaj periudhe në vend. Edhe pse trafikimi i fëmijëve për qëllime seksuale dhe prostituimi i fëmijëve, mbeten dy shfaqjet kryesore të shfrytëzimit seksual për përfitim, gjatë viteve të fundit, kanë lindur gjithashtu edhe prodhimi i imazheve abuzive të fëmijës dhe shfrytëzimi seksual i fëmijës në turizëm, të cilat krijojnë sfida të reja për agjensitë e mbrojtjes së fëmijëve.

Turizmi seksual i fëmijëve, ekziston sepse ka fëmijë dhe të rinj në situata të vështira.

Varfëria dhe problemet e tjera sociale, si mungesa e arsimit, mund t'i shtojnë të rinjtë në situata ku rrezikohen të shfrytëzohen. Për shembull, fëmijët e vegjël mund të binden të shkojnë me një abuzues në këmbim të ushqimit dhe strehimit, ndërsa adoleshentët mund të binden të shkojnë me një dhunues me shpresën për të marrë gjëra që kanë miqtë e tyre, si rroba dhe dhurata të tjera. Në turizmin e seksit të fëmijëve, fëmijët bëhen "lodra" për vizitorët dhe shfrytëzimi bëhet një mënyrë për të fituar të ardhura për veten ose për familjet e tyre.

Situata social-ekonomike e vendit, është një faktor kontribues ndaj trafikimit. Rritja ekonomike e viteve të fundit ka qenë e pabarabartë: disa zona të vendit kanë qenë më pak të favorizuara nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, gjë që ka nxitur migrimin brenda vendit nga zonat rurale drejt zonave urbane, nga veriu rural drejt qendrës dhe jugut të vendit (p.sh. në

Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, etj.). Komunitetet e reja të formuara si rrjedhojë e migrimit brenda vendit, janë edhe më vulnerabël ndaj trafikimit të personave, për shkak të lidhjes dhe mbështetjes së dobët të komunitetit të tyre.

Në Shqipëri nuk është kryer kërkim i mjaftueshëm për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, dhe nevojitet kërkim më i përqendruar për fëmijët lidhur me dhunën në shtëpi, në shkollë dhe në institucione të tjera. Nuk ka informacion të mjaftueshëm rreth shkallës ose përhapjes së abuzimit seksual të fëmijëve, punës së fëmijëve dhe shfrytëzimit të tyre. Të dhënat për shumë popullata të fëmijëve në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, janë të pamjaftueshme. Dhuna fizike, emocionale dhe psikologjike, si dhe ajo seksuale ndodhin sot në shtëpi, shkollë, komunitet dhe botën virtuale.

Në vitin 2021 me VKM Nr. 659, datë 3.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026” është miratuar Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026. Ky dokument synon të krijojë një mjedis të favorshëm për mirëqenien e fëmijëve nëpërmjet aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të çdo forme dhune dhe të zhvillimit në botën digjitale. Një ndër shtyllat strategjike të agjendës, është edhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, unifikimit të një kuadri ligjor dhe institucional të përmirësuar ndjeshëm, si dhe adresimit të formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, duke përfshirë dhe abuzimin e shfrytëzimit seksual. Një tjetër risi e kësaj agjende është ngritja e shërbimeve të specializuara për fëmijët viktime të abuzimit seksual dhe formave të tjera të rënda të dhunës <sup>1</sup>.

Sa i përket trajtimit të formave të ndryshme të dhunës të fëmijët, vihen re mungesa të theksuara në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, që nga identifikimi i hershëm, referimi dhe trajtimi i tyre. Kategoritë më vulnerabël, si fëmijët nga shtresat më të varfra të popullsisë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në institucione të përkujdesjes shoqërore, adoleshentët që i përkasin komunitetit LGBTI, fëmijët migrantë apo refugjatë, si dhe fëmijët që i përkasin komuniteteve romë dhe egjiptiane, janë në rrezik të shtuar ndaj formave të ndryshme të dhunës, si: bulizmi, stigma, abuzimi apo trafikimi. Të dhënat administrative të policisë në vitin 2017 tregojnë se 61 për qind (70 fëmijë) e të gjitha rasteve të abuzimit seksual në Shqipëri janë kryer kundër fëmijëve.

Një shqyrtim i kryer nga OSBE-ja, për viktimat e mundshme të trafikimit të fëmijëve në vitin 2020, evidentoi probleme madhore në lidhje me menaxhimin e rastit, ku përfshihej mungesa e vendimmarrjes së posaçme lidhur me identifikimin e trafikimit, mungesa e ndjekjes së hetimeve penale, si dhe mangësia shqetësuese në sigurimin e masave të mjaftueshme të mbrojtjes së fëmijës. Në këtë proces u evidentua nevoja e konsiderueshme për të fuqizuar sistemet për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri për sa i përket trafikimit të fëmijëve, nëpërmjet rritjes së trajnimit të palëve kyç të interesit, duke përfshirë oficerët e zbatimit të ligjit, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe shkollat.

Shfrytëzimi seksual dhe për punë, mund të çojë në pasoja të rënda që mund të zgjasin gjithë jetën si për zhvillimin fizik edhe atë psikologjik.

---

<sup>1</sup> 1 (Agjenda 2021-2026) <https://www.unicef.org/albania/media/4391/file/AKDF%202021-2026%20ALB.pdf>



Buxhetimi për fëmijët, është po ashtu një fushë veprimi për të cilën ka ende sfida në të kuptuarin dhe zbatimin e tij. Në këtë drejtim, kërkohet që të investohet në kapacitete dhe të planifikohen burimet e duhura për të zhvilluar në mënyrë periodike analizë buxhetore me përqendrim të fëmijët, si dhe ngritje kapacitetesh për buxhetimin me qendër fëmijën. Qëllimi kryesor, mbetet rritja e buxheteve për shërbimet për fëmijët, por edhe hartimi i instrumenteve që evidentojnë situatën e buxheteve dhe shpenzimeve – kjo në kuadër të një llogaridhënieje më të dobishme në fushën e të drejtave të fëmijëve. Prandaj, shteti ka për detyrë të garantojë dhe nxisë mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe të garantojë mbrojtje të mjaftueshme për fëmijët viktimë të abuzimit dhe trafikimit. Për më tepër, fëmijët viktimë të trafikimit dhe shfrytëzimit, kanë nevojë të posaçme dhe paraqesin sfida shtesë për profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve dhe agjencitë ligjzbatuese.

Shqipëria ka ngritur një kuadër kombëtar ligjor dhe institucional, bazuar në parimin e “interetit më të lartë të fëmijës” për parandalimin, mbrojtjen, hetimin, dhe ndjekjen penale të trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve. Së bashku me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Identifikimin, Referimin dhe Asistencën e Viktimave të Trafikimit, të përditësuara, ekziston një bazë e qëndrueshme ligjore që nxit bashkëpunimin ndërsektorial, për të luftuar të gjitha format e trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve.

### **Faktorët që ndikojnë mbi shfrytëzimin seksual të fëmijëve në turizëm**

Ka një sërë arsyesh të cilat favorizojnë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në turizëm. Pabarazia ekonomike dhe rritja dramatike e udhëtimeve në mbarë botën vitet e fundit, janë faktorë kontribues në këtë fenomen. Përsa i përket rritjes së të ardhurave dhe punësimit, industria e turizmit konsiderohet si një nga industritë më fitimprurëse në mbarë botën, duke u konsideruar si një mundësi kryesore e rritjes ekonomike për shumicën e vendeve. Zhvillimi i paplanifikuar, rritja e shpejtë dhe potenciali ekonomik krijojnë mundësitë për shfrytëzim të fëmijëve në nivel lokal.

Mungesa e strehës familjare, varfëria, problemet mendore dhe emocionale, destabiliteti familjar, varësia e njërit prej prindërve ndaj lëndëve narkotike, dështime në shkollë ose punë etj., radhiten tek shkaqet më të përhapura të abuzimit me fëmijët në industrinë e seksit. Sa më e vogël të jetë moshë e fëmijës dhe sa më pak përvojë jetësore të ketë për tu ballafaquar i vetëm në rrugë, aq më shumë shtohet mundësia për shkëmbim të seksit me para, veshje dhe strehë. Duke u rritur në një ambient dhe atmosferë të tillë, ai e ka më të lehtë të përfshihet në rrjete kriminale dhe përdorim të drogës, aq më tepër që e ka humbur besimin tek të rriturit përreth.

### **Arsyet e Shfrytëzimit Seksual e Fëmijëve në Turizëm përfshijnë**

#### **Anonimiteti**

Kur turistët janë larg shtëpisë, shumë përjetojnë një ndjenjë lirie nga përgjegjësia dhe kufizimet sociale, morale ose kulturore që ata ndjejnë si në shtëpi/ në vendin e tyre. Kjo ndjenjë anonimiteti, i shtyn ata të sillen në një mënyrë që nuk do ta bënin kurrë në shtëpi mes

bashkëmoshatarëve/njohurve. Është një ndjenjë e "askush nuk më njeh këtu - kështu që pse jo?"

### ***Injoranca Kulturore***

Turistët udhëtojnë nga një vend në tjetrin, për të përjetuar dhe njohur kultura të ndryshme. Kur ka dallime kulturore si gjuha, dallime sociale, dallime ekonomike ose fetare, vizitorët mund të bëjnë supozime rreth çfarë është e pranueshme brenda kulturës pritëse.

### ***Racionalizimi / "Të ndihmojmë të varfërit"***

Disa turistë, arsyetojnë se shfrytëzimi seksual i fëmijëve, i ndihmon ata me problemet e varfërisë. Vizitori mund të mendojë se fëmija po ndihmon për të mbështetur familjen e tij/saj dhe se duke blerë favore seksuale me fëmijën ai/ajo, po e ndihmon fëmijën dhe familjen e tij ekonomikisht.

### ***Ndjenja e superioritetit***

Udhëtimi mund të përforcojë paragjykimet. Turistët, veçanërisht kur udhëtojnë nga një vend i zhvilluar në një vend më pak të zhvilluar, shpesh kanë një ndjenjë të lartë superioriteti - qoftë kulturalisht apo ekonomikisht - ndaj individëve të vendit pritës. Paragjykimet e tyre i bëjnë ata të konsiderojnë persona në vendet më të varfra si inferiorë dhe shpesh nuk kanë skrupuj për shfrytëzimin e banorëve vendas.

## **Pasoja e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm**

Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve në Turizëm krijon ndikime negative në disa nivele:

#### **✓ Fëmija:**

Pasoja më e rëndë e abuzimit seksual bie mbi fëmijën, i cili është viktima kryesore e këtij fenomeni. Fëmija është në rrezik të lartë për t'u prekur nga sëmundjet e shëndetit mendor, si dhe ato seksualisht të transmetueshme, HIV/AIDS etj. Trauma është një bashkë-shoqëruese e jetës së këtyre fëmijëve, nëse ata nuk marrin trajtim dhe mbrojtje.

Shtatzënia, abortet dhe problemet e fertilitetit, janë gjithashtu çështje që atribuohen. Shumë fëmijë të abuzuar, kthehen në abuzues të substancave, shpesh edhe si mjet kontrolli nga abuzuesi apo shfrytëzuesi.

#### **✓ Komuniteti:**

Në nivel komuniteti, shfrytëzimi seksual komercial i fëmijëve, paraqet komodifikimin dhe zhvlerësimin e fëmijës. Fëmijët mund të shihen si objekte për t'u shitur ose tregtuar, ose të konsiderohen si "hedhje" sociale. Shfrytëzimi seksual komercial i fëmijëve, përfshirë edhe atë që ndodh në turizëm, kontribuon deri tek erozioni i vlerave dhe të drejtave njerëzore, i cili në fund kërcënon të tërësi shëndetin e shoqërisë.

Lind një domosdoshmëri për tu krijuar programe edukimi, parandalimi dhe mbështetjeje

me bashkëpunim ndërmjet qeverisë, organizatave joqeveritare dhe agjencive vendore.

“Duhet të zhvillohet një partneritet i konsoliduar, për të trajtuar gamën e përpjekjeve parandaluese dhe korrigjuese. Pika kryesore e bashkëpunimit do të ishte rritja e aftësive dhe kapaciteteve të indigjenëve në mënyrë që politikat dhe programet në një vend të bëhen gjithnjë e më shumë përforcuese për një zhvillim të qëndrueshëm.”<sup>2</sup>

### ✓ **Destinacioni**

Për vendin, shfrytëzimi seksual i fëmijëve në turizëm, mund të dëmtojë imazhin e destinacionit tek turistët dhe të zvogëlojë cilësinë e turizmit si produkt në përgjithësi. Nëse imazhi i një vendi bëhet shumë negativ, përfitimi ekonomik nga turizmi, minimizohet pasi turistët kërkojnë destinacione alternative.

## **Identifikimi i nivelit të ndërgjegjësimit dhe veprimit të industrisë shqiptare të turizmit për abuzimin e fëmijëve**

Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve në turizëm, ekziston pothuajse në çdo vend dhe shpesh ky fenomen u atribuohet turistëve. Megjithatë, abuzimi dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve, është para së gjithash një problem lokal.

Industria e turizmit së bashku me qeverinë, OJF-të, qytetarët vendas dhe vetë turistët, janë të gjithë aktorë që kanë përgjegjësi në fushatën për t'i dhënë fund abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm. Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual në përgjithësi dhe në turizëm në veçanti, është përgjegjësi jo vetëm e shtetit dhe e organizatave përkatëse, por është edhe përgjegjësi e çdo individi dhe qytetari.

Ky fenomen, është një shkelje e të drejtave themelore të fëmijëve, i cili çon në trajtimin çnjerëzor të tyre dhe i kthen fëmijët në objekte tregtare. Është shumë e rëndësishme për të gjithë aktorët të cilët operojnë, punojnë në industrinë e turizmit, të zhvillojnë një manual të kuptueshëm të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm, për të identifikuar mënyrat se si industria mund të ndër marrë veprime pozitive për t'i dhënë fund këtij fenomeni.

Ka pak të dhëna ose informacione mbi përhapjen e shfrytëzimit seksual të fëmijëve në sektorin e turizmit (SECTT) në Shqipëri. Fëmijë nga i gjithë vendi ende afrohen dhe rekrutohen online nga rrjetet kriminale dhe më pas sillen në qytete turistike si Vlora, Durrësi dhe Saranda, apo në qytete të tjera të mëdha si Tirana, Shkodra dhe Elbasani, për marrëdhënie seksuale. Shfrytëzimi seksual ndodh në hotele dhe motele, të rekrutuara po nga këto grupe kriminale. Rrjetet e organizuara, raportohet se janë të përfshirë dhe shpesh i joshin fëmijët me foto të hoteleve luksoze dhe stil jetese të lartë, apo me premtimin për vlera të larta monetare.

---

<sup>2</sup> Ahmed, Manzoor and Sara Ann Friedman. Education: A Force for Change. UNICEF paper submitted to the World Congress against Commercial Sexual Exploitation of Children. P 18-19.

Abuzimi seksual i fëmijëve në turizëm, duket se është i lidhur me modelet e brendshme të trafikimit të fëmijëve si një formë e trafikimit të fëmijëve për shfrytëzim seksual.<sup>3</sup>

## Rekomandimet

- ✓ Parandalimi përmes edukimit;
- ✓ Ofrimi efektiv i shërbimeve shëndetësore, edukimi i komunitetit dhe trajnimin, zhvillimin e familjes dhe komunitetit;
- ✓ Mekanizmat e raportimit dhe monitorimit;
- ✓ Ligjet : reformojnë ligjet ekzistuese/ krijojnë ligje të reja;

Përgjegjësia më e madhe për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual në turizëm, bie mbi qeveritë. Si hap urgjent dhe primar shteti duhet të mbledhë informacion mbi fenomenin për të kuptuar thellësinë e këtij krimi.

Shteti shqiptar, veçanërisht në nivel lokal, duhet të zhvillojë plane veprimi, dhe të marrë masa specifike për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual në turizëm. Kjo është veçanërisht shumë e rëndësishme, pasi turizmi kthehet në nivele të larta pas pandemisë. Agjencitë ligjzbatuese dhe operatorët e turizmit, duhet të informohen për fenomenin e abuzimit të fëmijëve dhe se si të mbrohen fëmijët nga ky shfrytëzim.

Gjithashtu thelbësore është të vihen në dispozicion më shumë fonde, për të siguruar shërbime të përshtatshme të kujdesit për fëmijët, mbrojtjen, edukimin dhe çështjet e ndërlidhura në nivel lokal.

Rritja e koordinimit ndërmjet njësive vendore dhe qeverisë qendrore, veçanërisht në kuadër të Agjendës së re Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, është një tjetër mekanizëm që ndihmon në evidenca, informim dhe monitorim. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, duhet të sigurojë që fëmijët viktimë të abuzimit seksual në turizëm, të mbrohen dhe tu ofrohen shërbime adekuate të kujdesit social në nivel lokal.

Ministria e Turizmit, në bashkëpunim me ministritë e tjera përgjegjëse për mirëqënien e fëmijëve, si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme, duhet të punojnë për zbatimin e një qasjeje të përbashkët (ngritjen e vetëdijes për operatorët e udhëtimeve dhe turizmit, politikat për fushatat informuese etj.), për të mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi seksual në industrinë e udhëtimeve dhe turizmit.

Kur qeveria/shteti bëjnë plane për të zhvilluar industrinë e udhëtimit dhe turizmit në vend, është e nevojshme që pikë së pari, të bëhet një vlerësim se çfarë ndikimi do të ketë tek fëmijët dhe komunitetet lokale. Shteti duhet të krijojë mbrojtje strikte të fëmijëve, të vendosë rregulla dhe udhëzime për industrinë e turizmit, si dhe për përzgjedhjen e njerëzve që bashkëpunojnë ngushtë me të dhe fëmijët, si përshebull, në shkollë, jetimore, etj.

---

<sup>3</sup> Global Initiative Against Transnational Organized Crime's Observatory of Illicit Economies in South Eastern Europe (May 2021).

Gjithashtu, shteti duhet të sigurohet që të jenë të disponueshme programet parandaluese për fëmijët në rrezik dhe programet e rehabilitimit dhe riintegrit për fëmijët viktime të fenomenit.

Shkrimi i një punimi kërkimor mbi gjetjet e temave të lartpërmendura, mund të propozojë rekomandime për sektorin privat, qeverinë dhe shoqërinë civile për ti mbrojtur më mirë fëmijët në Shqipëri si dhe strategji, politika dhe programe të mbështetura në një kuadër ligjor që garanton më shumë aksione.

Pra është e rëndësishme të kuptohet që jemi akoma në fazat e hershme të identifikimit, të parandalimit dhe monitorimit të këtij fenomeni. Mekanizmat që ngrihen, duhet të jenë të njohur për të gjithë aktorët në nivel institucional dhe në tregun privat. Nevojiten përpjekje konkrete për të identifikuar dhe për t'u përgjigjur trafikimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, sidomos në grupet më vulnerabël të fëmijëve.

Trainime dhe ngritje kapacitetesh për rritjen e ndërgjegjësimit mbi risqet dhe pasojat e kësaj forme të rëndë abuzimi, janë të domosdoshme që në fazat e para të organizimit të skemës parandaluese. Duhet marrë në konsideratë fakti, që zakonisht këto raste nuk raportohen nga fëmijët dhe është shumë e rëndësishme të njihet fenomeni dhe pasojat.

Trainimet duhet të kenë pjesmarrës Prindër; Zyrtarët e mbrojtjes së fëmijëve; Ofrues ndihme; Mësues; Punonjës socialë; OJF; Përfaqësues të sistemit të drejtësisë; Punonjës të shëndetit mendor; Media;

Prokuroria duhet të jetë një nga aktorët me rol kyç në adresimin e krimit, përse përket rasteve të shfrytëzimit seksual e më tej trafikimit të fëmijëve.

Stacionet e policisë, duhet të kenë SOP mbi identifikimin e rasteve, komunikimin me grupet e rrezikuara/eksponuara dhe ndërgjegjësimin në komunitet.

Të gjitha aktivitetet dhe ndërgjegjësimet publike duhet të dizajnohen në mënyrë të tillë që të përfshijnë publikun dhe ofruesit e shërbimeve në favor të fëmijëve dhe sidomos atyre që janë në risk për të qenë viktime të këtij fenomeni, me qëllim që fëmijët të mos dëmtohen më shumë.

Koordinimi i aktorëve dhe krijimi task forcave, është një tjetër mekanizëm që ndihmon në ndërgjegjësimin mbi fenomenin.

Sistemi i drejtësisë për të mitur ka nevojë të marrë në konsideratë, trajtimin e viktimave në një formë jo stigmatizuese e mbi të gjitha jo si të akuzuar nga ligji.

## 2. Zhvillimi i turizmit në Shqipëri

Evropa është burimi kryesor i turistëve që vizitojnë Shqipërinë, duke zënë një volum prej rreth 92.4% të të gjithë turistëve, çka reflekton se aksesit >3 orë nga një destinacion në tjetrin, është ende faktor i rëndësishëm për fluksin e udhëtarëve për qëllime turizmi. Megjithatë së fundmi turistët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo Azia dhe veçanërisht Kina, kanë shënuar një interes domethënës rritës, duke inkurajuar kështu indirekt zhvillimin e nënsektorëve të tjerë të turizmit, sidomos turizmin historik dhe atë kulturor<sup>4</sup>.

### 2.1. Zhvillimi i sektorit të turizmit

Industria e turizmit zë një vend kyç në ekonomi dhe është një burim i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Referuar të dhënave statistikore të Buletinit të Turizmit, në të cilën përfshihen të dhëna për hyrjet dhe daljet e vizitorëve në territorin shqiptar rezulton se:

**Për periudhën 2019-2021:** numri i përgjithshëm i vizitorëve të huaj ka shënuar një rritje të konsiderueshme, ku numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 5,688,649 nga 2,657,818 për vitin 2020. Pra shohim një rritje prej 3,030,831, vlerë kjo e rritur me 114%, ose 2,1 herë më shumë.


#### **Për periudhën Janar-Shkurt 2022<sup>5</sup>:**

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë dy muajve të parë të 2022 është 395,234 vlerë e rritur me 15 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Tabela 1: Të dhënat në fushën e turizmit	2019	2020	2021	Janar-Shkurt 2021	Janar-Shkurt 2022
Vizitorët e huaj në vite	6,406,028	2,657,818	5,688,649	343.502	395,234
Rritja Vjetore Progressive %	8,1	-58.5	114		
Vizitorët e huaj në netëqëndrim	6,096,341	2,459,209	5,513,832		
Rritja Vjetore Progressive %	8	-60	124,2		
Vizitorët e huaj për pushime	6,094,889	2,458,530	5,411,591		
Rritja Vjetore Progressive %	8	-60	120,1		

<sup>4</sup> <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

<sup>5</sup> Ministria e Turizmit



Nga paraqitja grafike për hyrjet e shtetasve të huaj që kanë hyrë në Shqipëri për vitet 2021, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2020 dhe 2019, vihet re se ka një rritje të ndjeshme krahasuar me 2020, por ende vijon një ulje të moderuar, krahasuar me vitin 2019.

## 2.2 Hyrja e vizitoreve të huaj sipas llojit të transportit

Në lidhje me raportin e mënyrës së transportit të zgjedhur nga vizitorët të huaj për të hyrë në Shqipëri, rrugët tokësore mbeten të preferuara. Në vitin 2021, me rrugë ajrore kanë mbërritur afërsisht 764 mijë shtetas të huaj, me një rritje prej me 183 %, por vlerë kjo në ulje të lehtë nga e njëjta periudhë e vitit 2019.

Numri i shtetasve të huaj dhe shqiptarë që mbërrijnë në Shqipëri me linjat detare për vitin 2021, ka qënë afërsisht 205 mijë, me një rritje prej 221% me të njëjtën periudhë të një viti më parë, por vlerë shumë më e ulët krahasuar me vitin 2019. Numri i shtetasve të huaj që mbërrijnë në vendin tonë nëpërmjet tokës ka qënë afërsisht 4.7 milionë, me një rritje prej 2.4 milion ose 103%, por në ulje krahasuar me vitin 2019.

Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet linjave ajrore zënë mesatarisht 16 % të hyrjeve gjithsej. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet linjave detare zënë mesatarisht 5 % të hyrjeve gjithsej. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet tokës zënë pjesën më të madhe me 79 % të hyrjeve gjithsej gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2021, vazhdon që hyrjet më të larta të mbeten shtetasit nga Kosova, me 2.6 milion, pra me një rritje prej 1.2 milion krahasuar me viti e shkuar dhe me një rritje të lehtë prej 17,5% krahasuar dhe me vitin 2019. Rritjen më të madhe për vitin 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020, e kanë shtetasit nga Poloni, SHBA, Spanjë dhe Zvicër konkretisht:

- Numri i shtetasve polakë të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 112,223, vlerë e rritur me 359.9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.
- Numri i shtetasve amerikanë të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 95,377, vlerë e rritur me 288.2% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.
- Numri i shtetasve spanjollë të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 12,567, vlerë e rritur me 348.7%, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.
- Numri i shtetasve Gjermanë të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 119,009, vlerë e rritur me 201.6%, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.
- Numri i shtetasve zviceranë të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 57,011, vlerë e rritur me 210%, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

**Tabela 2: Shtetet nga vijnë turistët në Shqipëri**

Shtetet	2019	2020	2021	Krahasimi (%)
Kosovë	2.246.540	1.379.360	2.640.447	1.9 here
Maqedoni	753.533	370.135	560.213	51.4
Greqi	596.884	203.445	276.915	36.1
Itali	467.745	467.745	354.37	-24.2
Angli	133.175	53.402	89.624	67.8
Mal i zi	366.817	174.233	319.77	83.5
Poloni	132.403	24.404	112.223	359.9
SHBA	119.179	24.57	95.377	288.2
Spanje	28.75	2.801	12.567	348.7
Gjermani	165.703	39.461	119.009	201.6
Zvicër	64.87	18.389	57.011	210
Të tjerë	6.406.038	2.657.818	1.051.123	2.5 herë me pak

Gjatë vitit 2021, hyrjet e shtetasve nga rajoni i Evropës, zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj me 5,172,845. Shtetasit nga Evropa që hyjnë në vendin tonë zënë mesatarisht 91 % të hyrjeve gjithsej.

Numri i shtetasve evropianë të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 5,172,845, vlerë e rritur me 3,935,309 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, por me një rënie të lehtë prej 601,381 për të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, hyrjet e shtetasve nga rajoni i Evropës, zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj me 98,5 %. Numri i tyre ka rënë me 54,9 %, krahasuar me një vit më parë.



Tabela 3: Vizitorë sipas kontinenteve	2019	2020	2021
I. Afrika	21,645	1,636	3,147
II. Amerika	153,579	30,020	115,833
III. Azia Lindore dhe Paqësori	66,757	4,993	7,968
IV. Lindja e Mesme	11,005	1,813	36,959
V. Azia e Jugut	3,167	801	20,998
VI. Evropa	5,774,226	1,237,536	5,172,845
Evropa Qëndrore / Lindore	371,988	92,326	363,483
- Evropa Veriore	234,902	65,173	127,767
- Evropa Jugore	4,635,974	956,542	4,331,888
- Evropa Perëndimore	416,983	95,211	293,054
- Evropa Lindore / Mesdheut	114,379	28,284	56,653
VII. Rajone të paspecifikuara	375,659	1,381,019	330,899

## 2.3 Strukturat Akomoduese

Gjatë vitit 2019 ka pasur 2116 struktura akomoduese njësi dhe gjatë vitit 2020, 2710 të tilla.

### Zonat më të frekuentuara

Gjatë viti 2021 numri i netë qëndrimeve të deklaruar, është rritur 2.1 herë më shumë se viti 2020. Në **zonat jo bregdetare** rritja vjetore e netë qëndrimeve është në masën 135 % krahasuar me vitin 2020. Ndërsa për nga **lloji i strukturës** është e dallueshme që numri më i madh i netë qëndrimeve është në **hotele dhe akomodime të ngjashme**. Kundrejt totalit për vitin 2021, vihet re se:

- numri më i madh i netë qëndrimeve sipas rajoneve, është në “Rajonin e jugut” (38 %);
- sipas zonave të afërsisë me bregdetin në “Zonat bregdetare” (75%);
- sipas llojit të strukturave akomoduese në “Hotele dhe akomodime të ngjashme” (94,8 %);

Më poshtë gjeni netë qëndrimet në tre vitet e fundit të ndarë sipas **rajoneve; zonës së afërsisë me bregdetin**; dhe sipas **llojit të strukturës akomoduese**:

Tabela 4: Netëqëndrimet sipas rajoneve, afërsisë me bregdetin dhe strukturën akomoduese

RAJONET	Netë/qëndrime t 2019	Netë/qëndrime t 2020	Netë/qëndrime t 2021	Ndryshimi në %
Rajonet e Veriut	1,078,360	461,800	824,644	79
Rajoni Qendër	1,076,512	387,375	1,145,547	196
Rajoni i Jugut	1,098,547	655,041	1,205,012	84
<b>Totali</b>	3,253,419	1,504,216	3,175,203	2,1 herë më shumë
<b>ZONA E AFËRSISË ME BREGDETIN</b>				
Zonë Bregdetare	1,913,448	1,068,965	2,380,694	122.7
Zonë Jo-bregdetare	1,339,971	342,240	804,262	135
<b>PERSHKRIMI I LLOJIT TË STRUKTURËS AKOMODUESE</b>				
Hotele dhe akomodime të ngjashme	3,002,289	1,478,022	3,008,704	103.6

<b>Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra</b>	221,669	115,957	149,278	28.7
<b>Hapësirat për kampingje, për parqe, për çadra ,rulo etj</b>	29,461	11,465	19,146	67

Siç shihet rritjen më të madhe e kanë netë qëndrimet në “Rajonin Qëndër”, krahasuar me vitin paraardhës, por kundrejt totalit “Rajoni i jugut” është më i preferuari për të qëndruar.

Në lidhje me netë qëndrimet sipas afërsisë me bregdetin, vihet re, që rritjen më të madhe krahasuar me vitin paraardhës e kanë netë qëndrimi në “Zonat Jo-bregdetare”, por kundrejt totalit vlera më e lartë arrihet nga netë qëndrimet në “Zonat bregdetare” për vitin 2021.

### 3. Kuadri rregullator dhe institucional për industrinë e turizmit në Shqipëri

Ligji Nr. 114/2017, për turizmin ka si qëllim të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse të sotme dhe të brezave të ardhshëm<sup>6</sup>. Ligji rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale si dhe subjekteve private. Ky ligj përcakton drejtimit kryesore të politikës shtetërore në fushën e turizmit, që bazohen tek parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe detyrat e Ministrisë së Turizmit dhe agjencive përkatëse për realizimin e këtyre qëllimeve. Në ligj parashikohet nxitja e punësimit të rinjve si një prioritet i rëndësishëm, nëpërmjet promovimit të edukimit turistik dhe programeve të posaçme, si dhe bashkëpunimi me të gjitha entitetet publike dhe private për zhvillimin e turizmit.

Në nenin 11 të këtij ligji, parashikohet ngritja e Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit (KKSPT), i cili është një organ këshillimor për sektorin e turizmit. Ky organ këshillon

<sup>6</sup> Një ligj i veçantë dhe një sërë aktesh të tjera rregullatore mbulojnë turizmin dhe marrëdhëniet mes institucioneve publike dhe private në Shqipëri: Ligji Nr. 114/2017 për turizmin, i ndryshuar.

- VKM Nr. 7306, datë 20.10.2016, miraton kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për kalsifikimin e strukturave akomoduese.
- Turizimi detar rregullohet me ligjin për aktivitetet e turizmit detar. (Ligji Nr. 43/20206)
- VKM-ja Nr. 845, datë 28.10.2020 përcakton rregullat e hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare për qëllime turistike dhe argëtim.
- VKM-ja Nr. 709, datë 12.10.2016 përcakton kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së agjencive të udhëtimit.
- Siguria në plazhe, parashikohet me VKM-në Nr. 321, datë 28.05.2014.
- VKM për mbështetjen e projekteve që nxisin turizmin, për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit, për investitorët.
- Strategjia e turizmit 2019-2023, si dhe udhëzime dhe urdhra ministri që trajtojnë veprimtaritë e udhërrëfyesve turistikë dhe mbledhjen, përpunimin e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit.

ministrin për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit përpara m iratimit të saj nga Këshilli i Ministrave:

- b) trajton dhe shqyrton çështje që kanë lidhje me veprimtarinë turistike të sektorit privat ose që mund të dalin gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie;
- c) siguron bashkëpunim ndërmjet sektorit privat dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin për çështje që mund të lindin gjatë zhvillimit të turizmit, zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit dhe Planit të Veprimit;
- ç) jep mendime mbi planifikimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit; d) jep mendime gjatë shqyrtimit të akteve ligjore që kanë lidhje me turizmin;
- dh) jep informacione për ecurinë e sektorit privat të turizmit dhe i sugjeron ministrisë përgjegjëse për turizmin marrjen e masave për çështje që kanë të bëjnë me turizmin.

### Kuptimi i turizmit seksual të fëmijëve

**Është shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe të rinjve nga persona të cilët nuk jetojnë në vendin ku ndodh abuzimi.**

- ✓ Përfshin abuzim nga udhëtarët vendas dhe ata të biznesit;
- ✓ Përfshin personat që shkojnë në vende të tjera për qëllime pune, duke përfshirë mësuesit, punëtorët për organizatat joqeveritare, punonjësit e kujdesit dhe të tjerët.

Shfrytëzimi Seksual i Fëmijëve në Turizëm, është një fenomen që ndodh kudo ku ka turizëm. Udhëtimi dhe turizmi, është një pjesë integrale e jetës së përditshme për shumë njerëz dhe vende dhe udhëtimet ndërkombëtare, janë bërë një ngjarje e zakonshme për shumë njerëz. Duke lehtësuar lëvizjen e kategorive të ndryshme, përfshihen edhe ata që mund tu referohemi edhe si “gjuetarët e seksit me fëmijët”.

Numri i udhëtarëve ndërkombëtarë është rritur ndjeshëm nga viti në vit dhe projeksionet e Organizatës Botërore të Turizmit (OBT), janë për rritje të vazhdueshme të kësaj lëvizjeje. Marrëdhënia e turizmit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, është kthyer në një shqetësim me fokus ndërkombëtar.

Ka individë në të gjitha rajonet që angazhohen dhe përfshihen në abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve, ndërsa udhëtojnë në vendet e afërta, apo edhe brenda vendit të tyre, dhe abuzimi i fëmijëve ndodh në çdo rrethanë ku krijohet mundësia.

Dega territoriale e shërbimit të turizmit është një tjetër strukturë administrative e ministrisë, që koordinon punën në terren për zbatimin e politikave të zhvillimit të produktit turistik dhe të menaxhimit të destinacionit turistik. Kjo strukturë sigurohet për përmbushjen e standardeve, ndërgjegjësimin e sipërmarrjeve turistike dhe komuniteteve. Po ashtu, mbledh të dhëna mbi dinamikën e turistëve dhe nevojave të tyre, si dhe bashkëpunon nga afër me strukturat vendore.

Komiteti rajonal i zhvillimit të turizmit, i përshkruar në nenin 20 të këtij ligji, është një tjetër organ që rregullon dhe bashkërendon punën mes organeve qendrore dhe atyre rajonale e

lokale. Ky komitet ka një përfaqësi të gjerë nga të gjitha institucionet dhe organizatat që veprojnë në nivel lokal me qëllim, trajtimin e çështjeve që lidhen me turistët dhe sipërmarrjen.

Inspektoriati ka rol si në monitorimin e situatës edhe në ndërgjegjësimin e subjekteve që zhvillojnë veprimtarinë për masat që duhet të marrin gjatë sezonit turistik.

Në nenin 11 të këtij ligji, parashikohet ngritja e Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit, i cili kryesohet nga ministri dhe në përbërje të tij ka përfaqësues nga shoqatat kombëtare të sipërmarrjeve, që operojnë në fushën e turizmit apo të lidhura me to, përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, dhomat e tregtisë, përfaqësues të shoqatave apo OJF-ve, që operojnë në fushën e turizmit, si dhe përfaqësues të institucioneve /donatorë ndërkombëtarë. Roli i këtij organi këshillimor fokusohet në planifikimin e zonave me përparësi në zhvillimin e turizmit, në sugjerime për masat që duhen marrë në fushën e turizmit dhe e bëm atë një organ kolegjal i cili mund të ndikojë ndjeshëm në politikën e turizmit.

Pavarësisht parashikimeve në ligj mbi hartimin e programeve apo strategjive që nxisin turizmin dhe evidentojnë zonat atraktive, vlen për tu theksuar që mungojnë si në ligj dhe në strategji objektivat dhe politikën e posaçme për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi seksual dhe trafikimi.

## 4. Kuadri ligjor, institucional dhe politikën në mbrojtje të fëmijëve nga shfrytëzimi seksual

Koncepti i mbrojtjes së fëmijës është relativisht i ri për Shqipërinë, ndërsa vendi përballet me shumë sfida në fushën e të drejtave të fëmijëve. Fëmijët vuajnë nga shkelje të rënda të të drejtave të tyre, ndërsa për mirëqenien e tyre rrallëherë diskutohet si një çështje prioritare nga politikanët dhe shoqëria në përgjithësi.<sup>7</sup>

### 4.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Ndërsa Shqipëria zhvillohet, sistemet për mbrojtjen e fëmijës dhe politikën shtetërore dhe vendore duhet t'u përgjigjen sfidave. Për të shkuar drejt një sistemi tërësor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Shqipëria duhet të bëjë kalimin nga politika për mbrojtjen e fëmijës e bazuar në çështje tek qasja që mbështetet në sistem, duke e vendosur theksin fuqimisht mbi zbatimin dhe duke bërë gjithë përpjekjet e mundshme që të bëhet i mundshëm ndryshimi, pra, duke investuar në mirëqenien dhe të ardhmen e fëmijëve.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë përpjekje për hedhjen e themeleve në Sistemin e Mbrojtjes së Fëmijëve. Kuadri bazë ligjor dhe i politikave për mbrojtjen e Fëmijëve u përforcua

<sup>7</sup> Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013-2014.

dukshëm në vitin 2017, me miratimin e Ligjit të ri për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, që është një entitet i përkushtuar institucional, ngriti një rrjet vendor të Punonjësve për Mbrojtjen së Fëmijëve (PMF), i cili zgjeroi mbulimin e shërbimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve në të gjithë vendin. Procesi është në përputhje me qasjen e "ndërtimit të sistemeve" për mbrojtjen e fëmijëve, i përqendruar në trajtimin e shkaqeve rrënjësore të cenueshmërisë së fëmijëve, dhe jo vetëm të simptomave. Megjithatë, i gjithë sistemi është në fillimet e tij dhe kërkon mbështetje të konsiderueshme, veçanërisht në nivelin e ofrimit të shërbimeve.

Në kuadër e politikave në lidhje me shfrytëzimin seksual në Shqipëri në këtë material, janë marrë në shqyrtim një sërë dokumentesh, të cilat adresojnë çështjet e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual.

Në Seksionin VI Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë<sup>8</sup>, ka parashikuar Krimet Seksuale ku nga Neni 100 deri në nenin 108, janë parashikuar krimet seksuale ku përfshihen edhe fëmijët. Në Seksioni VIII, janë parashikuar vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit.

Gjatë vitit 2021 Ministria e Brendshme<sup>1</sup> raporton se përsa i përket marrëdhënieve seksuale me të mitur të moshës nwn 14 vjec janë shënuar:

- 16 raste (neni 100).
- 12 raste për marrëdhënie seksuale deri 18 vjeç (neni 10).
- Referuar nenit 108, për vepra të turpshme raportohen 22 raste.
- 32 të mitur të dëmtuar nga ngacmimet seksuale (Neni 108/a)
- Shënohen 9 raste trafikimi të miturisht (Neni 128/b).
- Pornografia në internet— 124 raste (Neni 117/b).

Në nenin 113 parashikohet Prostitucioni, në nenin 114 parashikohet shfrytëzimi i prostitucionit, Neni 114/a shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese dhe në Nenin 117 Pornografia. Neni 128/b, trafikimi i të miturve parashikon dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve dhe e cilëson si rrethanë rënduese.

Rritja e ndërgjegjësimit si dhe informimi nga shkolla e familja ka sjellë rritje të raportimeve, veçanërisht përsa i përket poronografisë në internet. Megjithatë, ky numër nuk është tregues i mjaftueshëm i realitetit nëse kemi parasysh vështirësitë që hasin fëmijët për raportimin e rasteve që lidhen me çështje kaq delikate dhe të vështira për mentalitetin e shoqërisë sonë. Shqipëria si anëtare e Këshillit të Evropës, ka ratifikuar Konventën e Lanzarotës, e cila kërkon që shtetet palë të punojnë për të kriminalizuar të gjitha format e veprave seksuale ndaj fëmijëve dhe të miratojnë ligje dhe masa specifike për parandalimin e dhunës seksuale, mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen penale të autorëve të krimit. Ajo gjithashtu, promovon bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në këto fusha.

<sup>8</sup> [https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi\\_Penal-1.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf)

Shqipëria ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijëve me ligjin Nr. 7531, më 11 dhjetor 1991. Konventa e të drejtave të fëmijëve (KDF), që në vetvete përbëhet nga një numër standardesh dhe detyrimesh të panegociueshme, për të cilat është rënë dakord botërisht, ofron mbrojtje dhe përkrahje për të drejtat e fëmijëve. Për të arritur më tej qëllimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe zbatimin e dispozitave të saj, Shqipëria gjithashtu ka ratifikuar me ligjin Nr.9834, datë 22.11.2007, ""për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë"

Shqipëria ka Miratuar ligjin Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", gjë e cila ka qenë një përpjekje e madhe për ti dhënë një tjetër dimension sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Ky ligj, mbron fëmijët nga të gjithë format e dhunës dhe abuzimit duke i kushtuar vëmendje edhe mbrojtjes së fëmijëve nga trafikimi dhe çdo lloj forme shfrytëzimi dhe abuzimi seksual ndaj fëmijëve. Gjithashtu në këtë ligj janë përcaktuar dhe detyrat e aktorëve kryesorë për të mbrojtur fëmijët.

## 4.2 Politikat në mbrojtje të fëmijëve nga dhuna dhe shfrytëzimi

Me VKM Nr 659, datë 3.11.2021, u miratua Agjenda Kombëtare e Fëmijëve 2021-2026.

AKDF-ja konsolidon dhe krijon vazhdimësi me Planin e Veprimit për Fëmijë 2017–2020. Në vazhden e Agjendave të mëëparshme edhe kjo Agjendë përfaqëson një dokument strategjik, i cili shpreh përparësitë e institucioneve shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe njëkohësisht, një kuadër të unifikuar për monitorimin e progresit të qeverisë shqiptare drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, në të gjithë sektorët relevantë.

Ky dokument, u hartua duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e nxjerra nga raporti i monitorimit dhe vlerësimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020, që janë marrë plotësisht parasysh në vlerësimin e nevojave për ndërhyrje si pjesë e kësaj agjende.

AKDF 2021–2026 synon të krijojë një mjedis të favorshëm për mirëqenien e fëmijëve nëpërmjet aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të çdo forme dhune dhe të zhvillimit në botën digjitale. Impakti social i kësaj Agjende pritet të jetë në cilësinë e jetës së fëmijëve, adoleshentëve në familje e në çdo kontekst tjetër.

Një nga synimet kryesore të AKDF-së lidhet me koordinimin dhe forcimin e përgjegjshmërisë institucionale për të adresuar çështjet e fëmijëve. Ky dokument strategjik është në zbatim të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", i cili, përveçse ngarkon institucionet me përmbushjen e të drejtave bazuar në mandatin e tyre, përcakton edhe role të koordinimit ndërsektorial në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Agjenda e re vjen me një më të kompletuar ligjor për shkak të akteve ligjore që plotësojnë ligjin kuadër për mbrojtjen e fëmijëve. Ajo reflekton kryesisht objektivat e Agjendës

paraardhësve duke vendosur afate më konkrete për parime të rëndësishme si zhdukja e varfërisë dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve.

Më konkretisht, deri në vitin 2030, zvogëlohet të paktën gjysma e përqindjes së burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave, që jetojnë në varfëri në të gjitha përmasat e saj sipas përkufizimeve kombëtare;

- Zero uri;
- Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj të gjitha grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe llojet e tjera të shfrytëzimit seksual; dhe
- Eliminimi i të gjitha praktikave të dëmshme, të tilla si fëmija, martesë e hershme dhe e detyruar dhe gjymtimi i organeve gjenitale të grave;
- Masa të menjëhershme dhe të dobishme për të çrrënjësuar punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit njerëzor dhe për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të padenja të punës së fëmijëve, duke përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve ushtarë, dhe deri në vitin 2025 të përfundojë puna e fëmijëve në të gjitha format e saj;

Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit:

- Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri më 2020;
- mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në procese ligjore;
- sigurimi i përfshirjes sociale të të gjitha kategorive shoqërisht të përjashtuara etj.

Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017 e miratuar nga Ministria e Brendshme, e trajton trafikimin e fëmijëve si një problem shqetësues, ku fëmijët Shqiptarë trafikohen për një larmi qëllimesh, përfshirë ato për shfrytëzimin seksual.

Për fëmijët viktimë të dhunës, përfshirë viktimat e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, praktikave të dëmshme tradicionale dhe të gjitha formave të dhunës në shtëpi dhe familje, në bashkitë vendore duhet të ngrihen dhe të vihen në dispozicion, shërbimet për përgjigje në raste emergjente (p.sh.: strehëzat, shtëpitë kujdestare në situata krize). Hollësitë për kontaktimin e shërbimeve, duhet t'u bëhen të ditura fëmijëve, familjeve dhe të tjerëve që janë në kontakt me fëmijët (Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarotit).

Në rastet kur në shfrytëzimin seksual ose abuzimin seksual të fëmijës, janë të përfshirë prindërit ose kujdestarët e tij/e saj, ndër procedurat e ndërhyrjes duhet përfshirë mundësia e largimit të autorit të prezumuar të veprës, mundësia e largimit të fëmijës viktimë nga mjedisi i tij/i saj familjar. Kushtet dhe kohëzgjatja e këtij largimi, përcaktohen në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Shërbimet e integruara dhe shumë të specializuara për fëmijët viktimë të abuzimit seksual dhe formave të tjera të abuzimit, duhet të sigurohen dhe të ofrohen nga autoritetet shtetërore, duke pasur parasysh nevojën për një nivel më të lartë kompetencash, që bashkitë nuk i kanë.

Shhtesat e Kodit Penal, që u miratuan me Ligjin nr. 144/2013, dt. 20.5.2013, për të ofruar një garanci për mbrojtjen e përshtatshme të fëmijëve nga krimet seksuale dhe shfrytëzimi ekonomik. Këto ndryshime, ndihmojnë për harmonizimin e legjislacionit penal shqiptar me legjislacionin ndërkombëtar, sidomos, me Konventën e Lanzarotës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”

### **4.3 Pasqyra e përgjithshme e politikave për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual, veçanërisht në kuadër të turizmit.**

Tashmë prej vitesh, njohja, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, është listuar ndër veprimet prioritare të Qeverisë së Shqipërisë. Kjo edhe falë punës së jashtëzakoshme të organizatave të shoqërisë civile, të fokusuara në këtë drejtim. Kuadri ligjor i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, ka ardhur duke u përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit. Edhe në fushën e politikave dhe institucioneve zbatuese të tyre, vihen re përmirësime. Por, zbatimi në praktikë i kuadrit ligjor dhe atij të politikave, mbetet ende një sfidë, sidomos kur bëhet fjalë për mbrojtjen e fëmijëve, nga dhuna, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.

Ndryshimet e miratuara në Kodin Penal me ligjin Nr. 144/2013, dt. 20.5.2013, ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga krimet seksuale dhe shfrytëzimi ekonomik. Këto ndryshime, e sjellin legjislacionin penal shqiptar në linjë me legjislacionin ndërkombëtar, në veçanti me Konventën e Këshillit të Evropës (Konventa e Lanzarotit) “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”.

Ndër ndryshimet esenciale që mund të përmendim, është Neni 1, ku shtohen fjalët “të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve”. Gjithashtu, në Nenin 50, bëhen këto ndryshime: “e/1) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje;”. Ligjvënësi ndër të tjera, ka vendosur që të forcojë masën e denimit për krimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve, vepër e cila nga 15 vjet burg tashmë dënohet me 25 vjet burg. Në Kod është shtuar edhe një veër e re penale Neni 107, që ka të bëjë me dhunën me natyrë seksuale, ndërkohë që Neni 108 është ndryshuar i gjithi për të ofruar një mbrojtje më të lartë nga krimet seksuale për fëmijët e moshës 14-18 vjeç. Po në këtë vepër penale është përfshirë edhe tentativa për të takuar fëmijën për të pasur marrëdhënie seksuale me të.

Po ashtu një zgjidhje adekuate, është gjetur edhe për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Neni 124, paragrafi C i Kodit, është përmirësuar, duke përfshirë të gjithë format e shfrytëzimit të fëmijëve. Neni i ri thotë: “Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Janë ndërmarrë hapa pozitive për krijimin e strukturave dhe qasjeve të reja. Shqipëria ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm me miratimin e Ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” në vitin 2010 dhe ngritjen e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës me qëllim përmirësimin e monitorimit të politikave kombëtare lidhur me mbrojtjen e fëmijës. Për më tepër dhe veçanërisht, janë ngritur Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF



– e vetmja strukturë e specializuar në nivel vendor me një mekanizëm për trajtimin e çështjeve lidhur me këtë kategori fëmijësh.

**Përkufizimi i abuzimit seksual të fëmijëve:** Po ti referohemi përkufizimit, abuzimi seksual i fëmijëve është një lloj dhune ndaj fëmijëve, që mund të shfaqet në mënyra të ndryshme dhe ka karakteristika të veçanta që duhet të kuptohen për të siguruar një mbrojtje dhe parandalim efektiv për fëmijët. Organizata Botërore e Shëndetësisë (1999) e përshkruan abuzimin seksual të fëmijëve si: *"Përfshirja e një fëmije në një aktivitet seksual që ai ose ajo nuk e kupton plotësisht, nuk është në gjendje të japë pëlqimin e informuar ose për të cilin fëmija nuk është i përgatitur nga zhvillimi dhe nuk mund të japë pëlqimin ose që shkel ligjet ose tabutë shoqërore të shoqërisë. Abuzimi seksual i fëmijës vërtetohet nga kjo veprimtari midis një fëmije dhe një të rrituri ose një fëmije tjetër, i cili sipas moshës ose zhvillimit është në një marrëdhënie të përgjegjësisë, besimit ose fuqisë, aktivitet që synon të kënaqë ose plotëson nevojat e personit tjetër".*<sup>9</sup>

Fenomeni i dhunës seksuale ndaj fëmijëve është një fenomen global, shtrirja e të cilit nuk dihet me saktësi për shkak të vështirësisë që kanë fëmijët të raportojnë dhe të denoncojnë abuzimin e pësuar.

E njëjta vështirësi haset edhe në Shqipëri, ku mungojnë statistika të mirëfillta zyrtare dhe ku të dhënat shpesh mblidhen nga studimet dhe raportimet e organizatave joqeveritare, me objekt mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, apo nga raportime sporadike dhe të kufizuara të institucioneve shtetërore, që vendosen në kontakt me këtë fenomen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Megjithatë, mungon një bazë kombëtare të dhënash të koordinuara, e cila të mbledhë dhe të përpunojë të dhënat për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shqipëria, ka ratifikuar të gjitha konventat kryesore ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe është firmëtare e anëtare e iniciativave të tjera në rang ndërkombëtar dhe rajonal. Gjithashtu, Shqipëria ka miratuar dhe përmirësuar në mënyrë graduale legjislacionin në lidhje me shfrytëzimin seksual të fëmijëve, për të përmbushur angazhimet e saj ndërkombëtare dhe rajonale. Kështu, miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, në vitin 2017, ishin një hap i rëndësishëm përpara, drejt sigurimit të një niveli të përshtatshëm mbrojtjeje të fëmijëve nga shfrytëzimi seksual.<sup>10</sup>

Shqipëria ka bërë një progres të dukshëm në drejtim të zhvillimit të kornizës së politikave për mbrojtjen e fëmijëve, me dokumente të ndryshme politike dhe strategjike. Shumica e dokumenteve politike, janë fokusuar në aspektet e mbrojtjes së rasteve të dyshuara të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, ndërsa aspektet e parandalimit janë nënvlerësuar dhe duhet të forcohen më tej. Kryesisht ato janë përqendruar në: programet e infermierëve të patronazhit; fushatat e ndërgjegjësimit social; ndryshimin e qëndrimeve të shoqërisë, veçanërisht ato të të rinjve; mjediset mbështetëse për prindërimin pozitiv; ose programet e ndryshimit të sjelljes në shkolla. Aktualisht, Shqipëria po punon për përgatitjen e disa dokumenteve politike, që do të mund të integrojnë dhe të parashikojnë parandalimin, si një pjesë thelbësore dhe integrale e sistemit që targeton mirëqenien e fëmijëve dhe luftën ndaj abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve.

<sup>9</sup> Organizata Botërore e Shëndetësisë (1999)

<sup>10</sup> Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. (2017).

Por pavarësisht perpjekjeve, fëmijët janë ende të ekspozuar ndaj rrezikut të shitjes apo trafikimit, me qëllim që të shfrytëzohen seksualisht. Jashtë vendit, fëmijët shqiptarë identifikohen shpesh si viktima të trafikimit në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Greqi, Itali, etj.

Përveç formave të tjera të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, vitet e fundit në vendin tonë është evidentuar fenomeni i abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm.

Rritja e turizmit të Shqipëri, si kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar dhe egzistenca e trafikimit të brendshëm, rrisin rrezikun që fëmijët të bëhen viktima të turizmit seksual.

**Turizmi Seksual i fëmijës:** “është shfrytëzimi seksual i fëmijëve për përfitim nga persona që udhëtojnë nga një vend në një tjetër dhe atje angazhohen në veprime seksuale me minorenë”.<sup>11</sup>

Nga evidencat e nxjerra, është arritur në përfundimin se turizmi seksual i fëmijës, është i lidhur ngushtë me trafikimin e brendshëm të fëmijës dhe se ai po rritet dhe përhapet në Shqipëri. Qytetet ku vajzat e vogla shfrytëzohen seksualisht në industrinë e turizmit, përfshijnë Tiranën, Durrësin, Vlorën dhe Sarandën, pra kryeqytetin, qytet e mëdha dhe qytetet bregdetare. Kjo ndodh veçanërisht në verë, në stinën kur rritet turizmi.

Një rast i njohur i turizmit seksual të fëmijës, ndodhi në Maj 2007 kur Drejtori i një jetimoreje në Tiranë, e njohur si “Shtëpia e Fëmijëve të Tij”, u akuzua për abuzim seksual të fëmijëve dhe për dhënien e fëmijëve vizitorëve të huaj, me qëllim abuzimin seksual (përmes reklamave në Internet).<sup>12</sup>

Kodi i Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Udhëtim dhe Turizëm (Kodi), i nënshkruar në nëntor 2007 nga rreth 22 operator turistikë dhe hotelierë në Shqipëri. Kodi është një iniciativë e ndërmarrë me qëllimin për të rritur ndërgjegjësimin, për t’i dhënë mundësi dhe mbështetje sektorit të turizmit, që të parandalojë dhe reagojë kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Ceremonia e nënshkrimit u organizua në bashkëpunim mes Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) dhe Ministrisë së Turizmit, Ministrisë së Brendshme dhe organizatave nënshkruese. Aktivitetet pasuese, përfshijnë një fushatë ndërgjegjësuere kombëtare në zonat ndërkufitare dhe një fushatë që targetonte operatorët turistikë, si dhe përgatitjen e një kursi trainues për nënshkruesit e Kodit, organizuar nga OSBE.<sup>13</sup>

Gjithashtu, vihet re një mungesë e theksuar e angazhimit nga sektori i udhëtimeve dhe turizmit në Shqipëri, në luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe nuk ka të dhëna në lidhje me shfrytëzimin e fëmijëve në këtë kontekst. Gjatë viteve të fundit, vendi ka përjetuar një rritje të madhe të numrit të vizitorëve të huaj, por asnjë kompani shqiptare e

---

<sup>11</sup> Shfrytëzimi seksual i fëmijëve për qëllime përfitimi: CRCA 2009

<sup>12</sup> Shfrytëzimi seksual i fëmijëve për qëllime përfitimi: CRCA 2009

<sup>13</sup> Raport Botëror mbi Statusin e Veprimit kundër Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve për Përfitim-Shqipëria. ECPAT International 2008.

udhëtimeve dhe turizmit nuk ka nënshkruar Kodin e Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Udhëtime e Turizëm. Duke qenë se asnjë nga këto kompani nuk është bërë anëtare e Kodit, ka shumë vend dhe hapësira për të përmirësuar nivelin e angazhimit të këtij sektori, në luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

Pavarësisht nga këto përpjekje fillestare për të luftuar dhe parandaluar trafikimin seksual të fëmijëve veçanërisht në nivel kombëtar, ende nuk ka politika dhe mekanizma të përshtatshëm për të shmangur mundësinë që Shqipëria të kthehet në një destinacion relativisht “të sigurt” të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm. Legjislacioni penal shqiptar, nuk ka ndonjë parashikim specifik në lidhje me turizmin seksual të fëmijës (edhe pse shumica e akteve kriminale mbulohen në nene të tjera që kanë lidhje me abuzimin e fëmijës, përdhunimin, pornografinë e fëmijës etj.) dhe të dhënat mbi kriminalitetin, tregojnë shumë pak ose aspak për turizmin seksual të fëmijës. Politikat kombëtare, të tilla si strategjia antitrafikim ose Strategjia Kombëtare për Fëmijët, nuk kanë masa për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm. Për më tepër, agjensitë zbatuese të ligjit dhe operatorët turistikë kanë informacion shumë të kufizuar mbi turizmin seksual të fëmijës dhe mbi mënyrën se si duhet të mbrohen fëmijët nga shfrytëzimi në këtë sektor dhe për rrjedhojë nuk kanë adoptuar një metodë proaktive të trajtimit të kësaj shfaqje specifike të shfrytëzimit seksual të fëmijëve për përfitim.

## 5. Gjetje dhe rekomandime

Pavarësisht kuadrit ligjor të përmirësuar, koordinimi i strategjive sektoriale kombëtare me planet vendore, ka ende nevojë për përmirësim dhe ministritë sektoriale duket se po zbatojnë qasje të ndryshme të decentralizimit dhe transferimit të përgjegjësive. Roli identifikues dhe parandalues për problematikat që hasin fëmijët në nivel vendor është akoma i pastandardizuar dhe kjo reflektohet më tej edhe në ofrimin e shërbimeve.

Mungesa e të dhënave apo mospërdorimi i atyre të disponueshme, mekanizmat e dobët të planifikimit dhe koordinimit dhe konsultimi i pamjaftueshëm me aktorët e duhur vendor, përfshirë fëmijët dhe prindërit, sjellin vështirësi në monitorimin e situatës për fëmijët e ekspozuar ndaj shfrytëzimit seksual apo trafikimit. Për më tepër, bashkitë nuk kanë arritur të realizojnë detyrën e tyre të përcaktuar në ligjin nr. 18/2017, për të koordinuar, monitoruar dhe raportuar realizimin e të gjitha të drejtave të fëmijëve në nivel vendor. Kështu, mbetet domosdoshmëri prezantimi i një instrumenti apo mekanizmi që mundëson ndërveprimin dhe koordinimin e masave të të gjitha fushave të veprimit me përqendrim te fëmijët, duke përfshirë jo vetëm sektorët tradicionalë si arsimi, mbrojtja dhe shëndetësia, por edhe argëtimin, mjedisin etj.,

Sa i përket trajtimit të formave të ndryshme të dhunës të fëmijët, vihen re mungesa të theksuara në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, që nga identifikimi i hershëm, referimi dhe trajtimi i tyre. Kategoritë më vulnerabël, si fëmijët nga shtresat më të varfra të popullsisë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në institucione të përkujdesjes shoqërore, adoleshentët që i përkasin komunitetit LGBTI, fëmijët migrantë apo refugjatë, si dhe fëmijët që i përkasin komuniteteve romë dhe egjiptiane janë në rrezik të shtuar ndaj formave të ndryshme të dhunës, si: bulizmi, stigma, abuzimi apo trafikimi. Të dhënat administrative të policisë në vitin 2017 tregojnë se 61 për qind (70 fëmijë) e të gjitha rasteve të abuzimit seksual në Shqipëri janë kryer kundër fëmijëve.

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme në luftën kundër abuzimit të fëmijëve, Shqipëria vazhdon të jetë një vend ku fëmijët prostituohen, trafikohen, përdoren për pornografi ose turizëm seksual. Edhe pse Qeveria në nivelin lokal dhe kombëtar, ka ndërmarrë masa serioze për të luftuar dhe eliminuar trafikimin e fëmijëve, Shfrytëzimi seksual i Fëmijëve për arsye përfitimi, ende lulëzon për shkak të rrjeteve të krimit të organizuar, korrupsionit mes organeve policore dhe mungesës së kujdesit dhe mbrojtjes për fëmijën. Varfëria, mungesa e respektit për qëniet njerëzore, veçanërisht atyre vulnerabël dhe strukturat e pamjaftueshme dhe të papërshtatëshme të mbështetjes sociale të fëmijëve në nivelin lokal, vazhdimisht i venë fëmijët në rrezik për tu shfrytëzuar.

Është e nevojshme marrja e disa masave dhe ngritja e strukturave të posaçme:

1. Në koordinim me Agjencinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, rritja e buxhetit për fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Ngritje kapacitetesh/instrumentesh për të realizuar buxhetimin me qendër fëmijën në nivel qendror dhe vendor dhe mbi të gjitha, të rriten alokimet financiare në të mirë të fëmijëve.

2. Ngritja e njësive të specializuara për menaxhimin e rasteve të dhunës, si dhe ngritja e një protokolli të unifikuar mes ofruesve të shërbimeve për identifikimin e fëmijëve në risk trafikimi dhe trajtimin e fëmijëve të trafikuar apo shfrytëzuar seksualisht.
3. Hartimi dhe miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e T/VMT dhe për afrimi për aq sa është e mundur me direktivën 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”.
4. Përmirësimi i ligjit për të huajt përse i përket çështjeve të trafikimit.
5. Trajnimi i strukturave gjyqësore për t’u specializuar për veprat penale të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual, me qëllim për të hetuar në mënyrë proaktive rastet e trafikimit të personave, për të kryer në mënyrë efektive.
6. Marrëveshje ndër-institucionale për referimin, trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual.
7. **Marrja e masave nga Qeveria Shqiptare për mbrojtjen e fëmijëve nga turizmi seksual:** Qeveria e Shqipërisë, veçanërisht në nivelin lokal, nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për ti mbrojtur fëmijët nga hyrja në turizmin seksual të fëmijëve, në një kohë që turizmi në Shqipëri po rritet në mënyrë të konsiderueshme. Për më tepër agjencitë zbatuese të ligjit dhe operatorët turistikë, kanë informacion të kufizuar mbi turizmin seksual të fëmijës dhe mbi mënyrën se si mbrohet fëmija nga shfrytëzimi. Pa politikën e duhura dhe mekanizmat e zbatuar, Shqipëria rrezikon të bëhet një destinacion relativisht “i sigurt” në Evropë për shfrytëzimin seksual të fëmijëve për turizëm.
8. **Zhvillimi i politikave kombëtare për parandalimin e abuzimit të fëmijëve:** Krijimi i një strukture multisektoriale dhe e gjithë qasja e qeverisë, do të kontribuonte në mënyrë domethënëse në përmirësimin e parandalimit të abuzimit në vend.
9. **Përforsimi i mëtejshëm i ligjit mbi ndëshkimin fizik:** Megjithëse vendi ka ndërmarrë disa hapa të përshtatshme ligjore për ndalimin e ndëshkimit trupor në të gjitha mjediset, përpjekje të mëtejshme duhet të mundësojnë zbatimin e ligjit dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me efektet e dëmshme të tij.
10. **Zbatimi i programeve parandaluese të bazuara në evidencë:** Shumica e shërbimeve të ofruara nga institucionet e vendit, siç janë NJMF-të, janë të përqendruara në zbulimin e abuzimit dhe mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi i mëtejshëm, prandaj duhet vënë më shumë theksi në drejtim të zbatimit të programeve parandaluese të bazuara në evidenca. Kështu, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme në zbatimin e programeve parandaluese, të tilla si: vizitat në shtëpi, prindërimi pozitiv, trauma abuzive e kokës, mësimi i fëmijëve se si të

njohin shenjat e abuzimit seksual, programet parandaluese parashkollore dhe shkollore.

11. **Forcimi i përgjigjes nga sistemi për parandalim, bashkëpunim ndërsektorial dhe ndërtim të kapaciteteve.** Sektori shëndetësor, policia, arsimi dhe drejtësia, duhet të ofrojnë një qasje të koordinuar në ofrimin e shërbimeve cilësore për regjistrimin, zbulimin, trajtimin, parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, me qëllim zhvillimin e një sistemi të integruar për mbrojtjen e tyre. Roli dhe përgjegjësitë e secilit prej aktorëve në grupin multisektorial, duhet të operacionalizohen nga standarde të qarta dhe procedura të performancës në parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve.
12. **Përfshirja në strategjinë e Turizmit, e objektivave specifike për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi seksual.** Ndërtimi i protokollove të unifikuara mes operatorëve turistikë, ministrisë dhe autoriteteve lokale, si dhe monitorimi i tyre nga struktura përkatëse në ministri.
13. Duke marrë në konsideratë faktin, që ka struktura të mjaftueshme të parashikuara në ligj, që mund të koordinojnë për parandalimin e këtyre fenomeneve dhe monitorimin e tyre, del e nevojshme që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të vendosë objektiva konkrete për mbrojtjen e fëmijëve.

